




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Raport gjashtëmuor i punës

Janar - Qershor 2026

Korrik, 2026

I. SEKTORI I KULTURËS

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjëse për detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

Hartimin e planit për mbështetjen kulturore;

Udhëheqje me resurset lokale kulturore,

Udhëheqje me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës,

Organizimin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;

Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës;

Grumbullimin e shënimeve faktike mbi të arriturat në kulturë;

Bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës dhe raportimin për punët e drejtorisë;

Bashkëpunim me nivelin qendror nga fushë veprimtaria përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;

Regjistrimin e grupeve kulturore, ansambleve etj;

Mbështetje të aktiviteteve kulturore,;

Bashkëpunim me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ, e organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;

Përkrahje dhe ndihmë asociacioneve, shoqatave kulturore në aktivitetet e tyre;

Të ofrojë institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente edhe veprimtari të tjera);

Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë;

Të ushtrojë edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

Sektori i Kulturës

1. Aktivitetet kulturore tradicionale
 - Festa e 17 shkurtit
 - Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës (Homazhe në varrezat e Dëshmorëve)
 - Kremtimi i festave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i përvjetorëve të rëndësishëm, sipas kalendarit të përpiluar nga Sektori i Kulturës
2. Projektet kapitale afatgjata
 - Objekti i përhershëm i Muzeut të Qytetit (janë bërë investime të vogla ku edhe gjatë këtij viti është caktuar selia e përhershme dhe së shpejti pritet të fillojnë investimet kapitale) ku tashmë janë në procedurën e fundit të formimit të grupit punues ndërinstitucional dhe profesional

- Pritet të fillojnë investimet kapitale në Aneksin A dhe B në Qendrën e Kulturës ku procedurat e prokurimit janë në përfundim të vlerësimit
- Renovime në Bibliotekën e qytetit në pikën Tunnel i parë
- Ndërtimi i një amfiteatri veror
- Vendosja e fotografisë së heroit kombëtar Isa Boletinit në shesh

Punët administrative

Janë përpunuar 100 lëndë

Pjesë e komisionit Raporti i Performancës komunale për vitin 2025

Pjesë e raportimit Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2026

Pjesë e komisionit për Investime kapitale

Pjesë e komisionit për subvencione individuale

AKTIVITETET E SEKTORIT TË KULTURËS

Mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarëvajtjes së punëve në institucionet vartëse.

Jemi duke punuar për formimin e komisionit për të hartuar planin ideor mbi renovimet e Muzeut të qytetit.

Koncert me rastin e 17 shkurtit (Koncert në hapësirat e Muzeut të qytetit)

Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës

Aktivitete kulturore të mbështetura nga Sektori i Kulturës

Sektori i Kulturës mbas mbështetjes së aktiviteteve kulturore ka arritur të ketë mbi 60 aktivitete kulturore.

Vizitat në institucionet vartëse (Arsyeja e vizitave është sepse jemi duke filluar të bëjmë një evidentim të gjendjes faktike të shfrytëzimit të të gjitha hapësirave të cilat shfrytëzohen nga personat fizike apo juridikë, ku vizitat janë më se të domosdoshme.

Ditë përkujtimore kushtuar masakrës së rrugës së Kovaqëve

Koncert me muzikë klasike në Qendër të Kulturës (Organizuar nga Saranda Kutllovci Sylaj) në mbështetje të Dkrs 15-Prill

Fillimi i provave për një shfaqje nga Teatri i qytetit

Grupi i thurjes-aktivitet në Muzeun e qytetit- java e fundit të muajit Prill

Punëtori me argjile dhe fije tekstili Muzeu i qytetit- java e fundit të muajit Prill

Lexim nga grupi i grave lexuese në fund të muajit Prill në Bibliotekën e Qytetit "Latif Berisha"

Projekti për të filluar renovimin e Qendrës së Kulturës Aneksin A dhe B

Shënimi i ditës ndërkombëtare të Librit dhe ditës ndërkombëtare të vajzave në TIK

Tryeza shkencore "Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare"

Muzeu i qytetit

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Muzeu i Mitrovicës ka shënuar disa arritje të rëndësishme institucionale, profesionale dhe komunitare, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe avancimin e institucionit.

Anëtarësimi në NEMO (Network of European Museum Organisations) – një nga arritjet më të rëndësishme të muzeut duke e futur Kosovën në këtë rrjetzim, duke mundësuar qasje në rrjete ndërkombëtare, bashkëpunim profesional dhe shkëmbim të përvojave muzeale në nivel evropian.

Trajnimi ndërkombëtar për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore (CHwB Kosova & HeMO) – i mbajtur në Muzeun e Mitrovicës (20–25 prill), ku institucioni shërbeu si nikoqir për profesionistë të fushës dhe u zhvilluan praktika bashkëkohore të dokumentimit 2D dhe 3D të artefakteve.

Ekspozita komunitare “Vegëza” (18 maj – Dita Ndërkombëtare e Muzeve) – ekspozitë e realizuar në bashkëpunim me Grupin e Thurjes “Vegëza”, e cila promovoi trashëgiminë e punës së dorës së grave në rajonin e Mitrovicës dhe forcoi rolin e muzeut si hapësirë komunitare.

Sigurimi i selisë së përhershme për Muzeun e Mitrovicës – vendim i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, që përbën një hap historik për zhvillimin afatgjatë të institucionit dhe përmirësimin e kushteve të punës, ruajtjes dhe ekspozimit.

Zhvillimi i programeve edukative, ekspozitave dhe koncerteve kulturore – përfshirë aktivitete të shumta me shkolla, komunitet dhe institucione kulturore. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 4 koncerte kryesore në hapësirat e muzeut, përfshirë koncerte klasike dhe aktivitete muzikore të organizuara nga Shkolla e Muzikës “Tefta Tashko”, si dhe aktivitete të tjera artistike dhe kulturore në kuadër të programeve të hapura për publikun.

Këto arritje dëshmojnë përkushtimin e Muzeut të Mitrovicës në forcimin e rolit të tij si institucion kulturor, edukativ dhe komunitar në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

JANAR

Gjatë muajit janar janë zhvilluar aktivitete të ndryshme hulumtuese, edukative dhe institucionale.

U realizua takim me Shenaj Zejnullahun për hulumtimin e Teqesë Kadiri të Haxhi Shejh Kadri Efendiut. Po ashtu, u mbajt takim me prof. Afete Shalën lidhur me hulumtimin e temës së ekzodit të vitit 1999.

Drejtoresha e Muzeut zhvilloi takim me profesorët e Universitetit të Prishtinës, znj. Zanita Halimi dhe z. Arsim Canolli, me qëllim të fillimit të bashkëpunimit ndërmjet Muzeut të Mitrovicës dhe Departamentit të Antropologjisë për hulumtimin e temës së projektit për ekzodin.

Muzeu u vizitua nga nxënësit e SHFMU “Nonda Bulka” dhe SHFMU “Ismail Qemali”.

U mbajt takimi i radhës i Grupit të Thurjes “Vegëza”, ndërsa Muzeu i Mitrovicës aplikoi për anëtarësim në rrjetin evropian muzeor NEMO (Network of European Museum Organisations).

SHKURT

Gjatë këtij muaji u hartua projekt-propozimi me titull “Ekzodi i vitit 1999 në Mitrovicë: Kujtesë, Dëshmi dhe Memorie Kolektive”.

U mbajt takim kolegjal me stafin e muzeut, ku u diskutuan aktivitetet aktuale dhe planet e ardhshme të punës.

Drejtoresha e Muzeut, znj. Nora Prekazi, realizoi takim zyrtar me drejtorin e Trepçës, z. Shyqyri Sadiku, ku u diskutuan çështje me interes të përbashkët dhe mundësitë e bashkëpunimit institucional.

Vazhdoi procesi i risistemimit dhe inventarizimit të monedhave muzeale, si dhe përzgjedhja dhe riorganizimi i fotografive nga fototeka e muzeut.

Muzeu mirëpriti vizitën e nxënësve të German School of Kosova, si dhe të nxënësve të SHFMU “Abdullah Shabani” dhe SHFMU “Zenit” nga Prugovci i Prishtinës.

Në kuadër të Programit Edukativ të Grupit të Thurjes “Vegëza”, u realizua intervistë me znj. Igballe Fazliu me qëllim të dokumentimit të çejzit.

Gjatë muajit shkurt u realizua program edukativ me aktivitete kreative, artistike dhe festive në muze.

Më 13 shkurt 2026 u mbajt takimi i Grupit të Thurjes “Vegëza”.

Më 16 shkurt 2026 u realizua punëtori me nxënësit e SHFMU “Xhevat Jusufi” nga Bare. Po atë ditë, në Sallën e Etnologjisë u mbajt koncert klasik nga SHFMU “Tefta Tashko”.

Më 17 shkurt 2026, me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, muzeu ishte i hapur për vizitorë gjatë gjithë ditës.

Në kuadër të manifestimit zyrtar për nder të 18-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, mbrëmë në muze u mbajt koncert klasik i organizuar nga SHFMU “Tefta Tashko”, si dhe vizitë në ekspozitat muzeale. Përveç audiencës së gjerë dhe artdashësve, në këtë ngjarje ishte i pranishëm edhe Kryetari i Mitrovicës, z. Faton Peci, Nënkryetari z. Enis Osmani, si dhe drejtore nga Komuna e Mitrovicës.

Po ashtu, u realizuan takime online me Rrjetin e Muzeve Ballkanike.

Artistja Elena Galina dhuroi dy fotografi nga ekspozita “Çiknia”.

Muzeu i Mitrovicës u pranua si anëtar i NEMO-s (Network of European Museum Organisations).

Vazhdoi procesi i dokumentimit të çejzit nga znj. Valbona Prekazi, znj. Kujtesa Prekazi dhe znj. Xhyla Haziri.

Në bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra u vazhdua puna për hartimin e katalogut etnologjik.

Drejtoresha dha intervista për Radio Televizionin e Kosovës dhe Radio Kosovën.

MARS

Në kuadër të pranimit të Muzeut të Mitrovicës në rrjetin NEMO, drejtoresha dha intervistë për RTK, duke prezantuar rëndësinë e këtij suksesi për institucionin.

Grupi i Thurjes “Vegëza” dhuroi punimet e realizuara për fëmijët e SOS Fshatit të Fëmijëve.

Muzeu u vizitua nga nxënësit e SHFMU “Musa Hoti”.

Gjatë këtij muaji u përcaktuan datat për zhvillimin e Programit Edukativ “Muzeu Lëvizës”, i cili u realizua më 24 dhe 25 mars në Muzeun e Lëvizjes në SHFMU “Musa Hoti” në Frashër.

Drejtoresha realizoi intervista për RTK dhe KTV Express lidhur me anëtarësimin në NEMO dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin muzeor.

Po ashtu, u zhvillua një intervistë me z. Korab Krasniqi lidhur me studimin mbi memorializimin dhe hapësirën publike në Kosovë.

Gjatë muajit u përgatit dhe u aplikua projekti “Trashëgimia në Veprim – Programi Edukativ Komunitar i Muzeut të Mitrovicës” për Ambasadën e Luksemburgut.

U hap faqja zyrtare e Muzeut të Mitrovicës në platformën LinkedIn.

Muzeu mirëpriti 22 studentë dhe studiues nga Laboratori i Arkeologjisë dhe Antropologjisë i Universitetit të Gjenevës në kuadër të një vizite studimore në Ballkan.

Në kuadër të Programit Edukativ “Muzeu Lëvizës”, u zhvillua punëtori me nxënësit e SHFMU “Musa Hoti”, si dhe takimi i radhës i Grupit të Thurjes “Vegëza”.

Muzeu u vizitua nga nxënësit e SHFMU “Andon Zako Çajupi” nga Bardhoshi i Prishtinës.

Drejtoresha zhvilloi takime me prof. Zanita Halimin lidhur me projektin “Ekzodi” dhe me drejtorin e SHFMU “Bedri Gjinaj”, z. Enis Kelmendi, lidhur me temën “Trashëgimia Sportive e Mitrovicës”.

Muzeun e vizituan Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Gazmend Asllani, dhe shefi i Kulturës, z. Arbër Hajra.

Në fund të muajit, stafi i muzeut realizoi vizita studimore në Muzeun e Nënë Terezës dhe në Muzeun Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit.

Nga takimet e rregullta të grupit të thurjes “Vegëza”, me iniciativë të vetë grave të grupit, u thurën dhe u dhuruan kapela dhe shalla të punuara me shumë dashuri për fëmijët e SOS Fshati i Fëmijëve në Kosovë.

PRILL

Në fillim të muajit muzeun e vizituan nxënësit e SHFMU “Hasan Prishtina” nga Millosheva.

U hartua projekt-propozimi “Trashëgimia Sportive e Mitrovicës: Hulumtim, Dokumentim dhe Prezantim Muzeor”, i cili iu prezantua historianit Enis Kelmendi për bashkëpunim në realizimin e tij.

U zhvillua takim online me arkeologët Lekë Shala dhe Kaltrina Igrishta për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit për një projekt të ri rreth tekstilit.

Organizata CHwB realizoi vizitë në muze për të shqyrtuar mundësitë e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Gjatë periudhës 20–25 prill, në Muzeun e Mitrovicës u mbajt trajnimi për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, i organizuar nga CHwB Kosova në bashkëpunim me Ukraine Heritage Monitoring Lab (HeMO). Trajnimi u fokusua në dokumentimin dhe digjitalizimin 2D dhe 3D të artefakteve muzeale përmes metodave bashkëkohore, përfshirë fotogrametrinë 3D dhe menaxhimin afatgjatë të të dhënave digjitale.

Muzeu i Mitrovicës shërbeu si institucion nikoqir, duke mirëpritur përfaqësues të muzeve të ndryshme të Kosovës, si dhe u dy zyrtare u pajisën me certifikata.

Gjatë këtij trajnimi muzeun e vizituan drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Gazmend Asllani, si dhe zëvendësministrija e Kulturës, znj. Nora Arapi.

MAJ

Gjatë muajit maj, Kuvendi Komunal i Mitrovicës mori vendim që Muzeut të Mitrovicës t'i ndahet selia e përhershme, duke siguruar kushte më të mira për funksionimin e tij.

Muzeu u vizitua nga nxënësit e shkollës Kosovo Leadership Academy.

Gjatë kësaj periudhe u punua në arkivin e muzeut, përfshirë pastrimin e artefakteve të sektorit të etnologjisë dhe përgatitjen e katalogut etnologjik në bashkëpunim me Fondacionin Dhemetra.

Me 18 Maj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve u hap ekspozita komunitare “Vegëza”, e cila prezantoi punimet e Grupit të Thurjes. Përmes punimeve të thurjes, qendisjes dhe qepjes, ekspozita trajtoi punën e dorës së grave në rajonin e Mitrovicës. Në hapjen e ekspozitës morën pjesë Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Gazmend Asllani, si dhe qytetarë të shumtë.

Me rastin e hapjes së ekspozitës, drejtoresha dha intervista për RTK dhe media të tjera.

Gjatë muajit muzeu u vizitua nga nxënës, vizitorë vendorë dhe të huaj.

Muzeu u pajis me pajisje të reja teknologjike nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në hapësirat e Muzeut të Mitrovicës u mbajt nata qendrore e edicionit të gjashtë të Festivalit të Letërsisë “ZaNa”, me temën “Trupi”.

Si dhe gara të Festivalit Muzikor “Mitrovica International Classical Competition”.

QERSHOR

Gjatë muajit qershor muzeu u vizitua nga vizitorë vendorë, pjesëtarë të diasporës dhe vizitorë të huaj të grupmohave të ndryshme.

Në Sallën e Etnologjisë u mbajtën disa koncerte të organizuara nga Shkolla e Muzikës “Tefta Tashko”.

Muzeu u vizitua nga nxënësit e QSI “International School of Kosova” nga Prishtina.

Studiueses Hana Ibri nga King's College London iu ofruan të dhëna dhe materiale lidhur me trashëgiminë kulturore të Mitrovicës për qëllime studimore.

Në hapësirat e Muzeut të Mitrovicës, Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me Departamentin e Historisë të Universitetit të Prishtinës, organizoi tryezën shkencore me temën “Roli i Isa Boletinit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”. Në këtë aktivitet u prezantuan kumtesa nga dhjetë profesorë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në tryezë morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci, si dhe Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Gazmend Asllani.

Muzeu, mori pjesë në një takim online të organizuar nga NEMO, me ç'rast u pajis me certifikatë pjesëmarrjeje.

Drejtoresha e Muzeut, znj. Nora Prekazi, zhvilloi takim me znj. Merita Shyti nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të diskutuar çështjen e vazhdimësisë së procedurave për trajtim të objektit të muzeut.

Drejtoresha e Muzeut, znj. Nora Prekazi, prezantoi punën dhe aktivitetet e muzeut para UN Youth Assembly, në kuadër të një konference të mbajtur në Istog, ku mori pjesë si drejtoreshë e muzeut dhe aktiviste e komunitetit.

Më 19.06.2026 u mbajt një takim koordinues ndërmjet përfaqësuesve të DKRS-së, Muzeut të Mitrovicës dhe QRTK-së, ku u diskutua procesi i muzealizimit të ish Objektit të Armatës në Muze të Përhershëm të Mitrovicës. U dakordua krijimi i një grupi punues multidisiplinar me ekspertë nga fusha të ndryshme, i cili do të hartojë rekomandimet profesionale, kriteret dhe detyrat projektuese për ndërhyrje në objekt dhe konceptimin muzeal. Po ashtu, u theksua se kompania projektuese duhet të jetë e licencuar për trajtimin e objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe u diskutua mundësia e një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komunës dhe MKRS-së për koordinimin e investimeve në fazën e implementimit të projektit.

Ambasadori i Austrisë në Kosovë, George Schnetzer, së bashku me ekipin e tij në Kosovë, në kuadër të vizitës në Trepça, vizituan edhe Muzeu i Mitrovicës.

Puna Muzeale dhe Ekspozitat

Në vitin 2026, Muzeu i Mitrovicës ka realizuar një sërë iniciativash të suksesshme për të bërë muzeun një Muze Gjithëpërfshirës për ta realizuar vizionin si Muze i të Gjithëve. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (DKRS), Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), OJQ-të dhe partnerët lokalë, muzeu ka avancuar përfshirjen dhe qasjen për vizitorët e të gjitha grupmoshave dhe grupeve të marginalizuara, duke garantuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet muzeale dhe edukative.

Ky proces ka përfshirë rishikimin e ekspozitave të përhershme, pasurimin e narrativave shpjeguese muzeale dhe afrimin e vazhdueshëm të muzeut me komunitetin. Veçanërisht, janë zhvilluar aktivitete edukative gjithëpërfshirëse, duke përfshirë:

Grupi i Thurjes – një aktivitet krijues dhe edukativ për të gjitha grupmoshat, duke rikthyer artin e thurjes tradicionale dhe duke bashkuar breza të ndryshëm.

Punëtori vizatimi për fëmijë – aktivitet i dedikuar për nxënësit, për të nxitur kreativitetin dhe njohuritë mbi trashëgiminë kulturore.

Punëtori me argjile dhe fije tekstili – për fëmijë dhe të rritur, organizuar në bashkëpunim me shkolla lokale, për të zhvilluar aftësi artistike dhe kreativitetin.

Program me të rinj nga komuniteti me Sindromën Down – një hapësirë për përfshirje aktive dhe zhvillim të aftësive artistike për grupet me nevoja të veçanta.

Programi edukativ “Muzeu Lëvizës” – Muzeu dërgoi aktivitete arti tek fëmijët e fshatit Bare si dhe bashkëpunime të tjera me shkolla dhe qendra burimore lokale, duke përfshirë pjesëmarrës me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, muzeu ka realizuar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën muzeale, duke përfshirë rregullimin e hapësirave me lyerjen e sallave për të siguruar një prezantim më profesional të koleksioneve. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit të muzeut, duke e pozicionuar Muzeun e Mitrovicës si një institucion të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për promovimin e trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, si dhe duke përmirësuar përvojën kulturore të vizitorëve.

Ekspozita "Vegza"

Hapur më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve.

Grupi i Thurjes

3. Aktivitet krijues për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë gra artizane dhe pjesëtare të komunitetit. Qëllimi: Rikthimi dhe promovimi i thurjes si pjesë e trashëgimisë kulturore


Vizitorët


Gjatë vitit 2026, Muzeu i Qytetit të Mitrovicës mirëpriti një numër të konsiderueshëm vizitorësh, duke përfshirë:

Grupa nga shkollat fillore dhe të mesme.

Studiues dhe studentë nga universitete të ndryshme.

Vizitorë individualë dhe familjarë, vendorë, të huaj dhe bashkatdhetarë





Biblioteka e qytetit “Latif Berisha”

Sektori i përpunimit janë përpunuar gjithsej 149 ekzemplar.

Në sektorin e fëmijëve, ku gjatë vitit 2026 janë anëtarësuar gjithsej 132 fëmijë dhe ka pasur 6104 shërbime.

Në sektorin për të rritur janë anëtarësuar 67 anëtar të rinj dhe ka 1817 shërbime.

Në sektorin e profesional janë anëtarësuar 44 anëtar dhe ka 942 shërbime

Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica

Janar:

23.01.2026 - UBT Kosova prezantuan një ekspozitë “Pop Up” me punime të studentëve të programit Art dhe Media digjitale.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 18:00.

Shkurt:

04.02.2026 - Ekspozitë përkujtimore për masakrën e 3 dhe 4 shkurtit në Mitrovicë, me autor Halit Barani.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 12:00.

11.02.2026 - Master Class me Maestro Giuseppe Devastato.

Salla e Kinemasë, në ora 9:00 - 18:00.

12.02.2026 - Ekspozitë nga Bashkësia Islame e Kosovës “Kujtesa në fotografi” për xhamitë e shkatërruara gjatë luftës në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë gjatë viteve 90’.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 13:00.

13.02.2026 - Koncert për fëmijë nga “Cicërimat buzë Ibrit”.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

17.02.2026 - Film dokumentar “Betejat e Veriut” me autor Bashkim Myftari.

Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

Mars:

11.03.2026 - Shfaqja “Fjalët lëndojnë” nga SH. M. L. M “Xheladin Deda”.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

24.03.2026 - Akademi përkujtimore në 27 vjetorin e rënies së veprimtarëve Latif Berisha dhe Agim Hajrizi.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

25.03.2026 - 26.03.2026 - Master Class me Maestro Giuseppe Devastato.

Salla e Kinemasë, nga ora 10:00 - 17:00.

27.03.2026 - 5 vjetori i themelimit të ansamblit “Shqipet e vogla”.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Prill:

15.04.2026 - Mbrëmje e muzikës klasike në Mitrovicë. Koncert nga Sibora Resyli.

Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

27.04.2026 - Panairi i punës, organizuar nga organizata rinore AKTI.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 9:00.

29.04.2026 - Aktivitet kulturor për shënimin e Ditës Botërore të Vallëzimit. Organizuar nga Qendra e Kulturës.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

30.04.2026 - International Piano Balkan Academy. Organizuar nga Melisa Ibrahim.

Salla e Kinemasë, nga ora 9:00 - 18:00.

Maj:

08.05.2026 - Tubim i partisë “Guxo” me strukturat në Mitrovicë.

Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

12.05.2026 - Dokumentar i cili trajton historitë e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.
(BIRN Kosova).

Salla e Kinemasë, në ora 15:00.

21.05.2026 - Filharmonia e Kosovës dhe kori e orkestra e Fakultetit të Arteve.

Salla e Kinemasë, në ora 19:30.

23.05.2026 - Tubim elektorale nga “Vetëvendosje”.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 11:30.

31.05.2026 - Akademi përkujtimore për heroin Safet Peci - Boletini.

Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Qershor:

01.06.2026 - Aktivitet për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve nga organizata: “Mundësia” “Down Syndrome Kosova” Shqipet e vogla” dhe “HandiKos Mitrovica”.

Salla e Kinemasë, në ora 16:00.

02.06.2026 - Tubim elektorale nga LDK.

Salla e Kinemasë, në ora 17:00.

03.06.2026 - Mitrovica Classical Competition - Gara e Muzikës Klasike.

Salla e Kinemasë, nga ora 8:00 - 16:00.

04.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU “Shaban Idrizi”

Salla e Kinemasë, në ora 11:00 - 14:00.

05.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU “Bedri Gjinaj”.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00 - 14:00.

06.06.2026 - Mitrovica Classical Competition - Gara e Muzikës Klasike.

Salla e Kinemasë, në ora 08:00 - 18:00.

09.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU “Ismail Qemajli”.

Salla e Kinemasë, në ora 17:00 - 21:00.

Pjesëmarrja, rreth 30 persona.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci, organizoi debat me përfaqësues të institucioneve kulturore si dhe akterë të fushave të ndryshme në Mitrovicë, për hartimin e Kalendarit Vjetor të aktiviteteve kulturore.

Qendra e Kulturës "Rexhep Mitrovica", në bashkëpunim me Shkollën e Muzikës "Tefta Tashko", Garën Ndërkombëtare të Muzikës Klasike "Mitrovica International Classical Competition", Shoqatën e Muzicentëve të Mitrovicës "Cicërrimat Buzë Ibrit", organizuan koncertin festiv për nder të Ditës Botërore të Muzikës.

Qendra Mësimore RADC organizoi koncert dhe aktivitete kulturore në Qendrën e Kulturës në Mitrovicë. Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e diversitetit kulturor të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Rok-grupi muzikor "Marigona", në sallën e Qendrës së Kulturës, bëri xhirimin e videospotit të ri.

Shkolla e Muzikës "Tefta Tashko" organizoi koncertin recital të nxënëses Lisa Abdullahu

Korrik 2026

Në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" u organizua ceremonia e nënshkrimit të kontratave për praktikantët me pagesë.

Gjendja aktuale në Qendrën e Kulturës është relativisht e mirë. Në këtë institucion zhvillohen shumica e aktiviteteve kulturo-artistike në qytet, duke pasur parasysh se në këtë objekt veprimtarinë e zhvillojnë dy institucione kulturore. Vlen të theksohet se të gjitha aktivitetet në këtë institucion zhvillohen në sallën qendrore dhe hollin e qendrës, kurse salla e konferencave, si dhe salla e leximit, që nga renovimi i objektit kanë mbetur jashtë funksionit. Riaktivizimi i këtyre dy sallave do të kompletonte infrastrukturën kulturore brenda objektit.

Ky institucion ka një staf prej 8 punonjësish - drejtorin, stafin administrativ-financiar dhe stafin teknik dhe mbështetës. Institucioni ka Statutin, i cili e rregullon statusin juridik mbi funksionimin e Qendrës së Kulturës, por nuk ka Rregullore të brendshme dhe xhirollogari bankare. Sipas Rregullores për Tarifa, Taksa dhe Gjoha Komunale, Qendra e Kulturës mund të gjenerojë të hyra nga aktivitetet që zhvillohen në hapësirat e institucionit.

Duke e ditur se menaxhimi i objekteve që kanë hapësirë të madhe kërkon edhe mirëmbajtje dhe krijim të kushteve të përshtatshme për organizimin dhe avancimin e jetës kulturo-artistike, është shumë e dukshme mungesa e stafit higjieno-sanitar në këtë institucion. Po ashtu edhe mungesa e një përgjegjësi për operimin dhe kujdesin për ngrohjen qendrore. Ende është e dukshme gjendja e cila është shkaktuar nga renovimi, ani pse parë në disa aspekte teknike renovimi e ka rivitalizuar këtë objekt, por megjithatë janë të dukshme edhe disa dëme që janë shkaktuar gjatë kohës së renovimit sidomos nga rrjedhja e ujit atmosferik brenda objektit, por edhe mbikëqyrja jo e mirë e punimeve të zhvilluara në këtë kohë.

Objekti nuk ka roje fizike, por është i monitoruar nga kamerat brenda dhe jashtë objektit. Siguria në këtë objekt dhe rreth tij duhet të shikohet me prioritet si në angazhimin e sigurimit fizik, po ashtu edhe në shtimin e numrit të kamerave brenda dhe jashtë objektit.

Në hyrje të këtij institucioni dhe brenda tij mungojnë shënjestimet - tabelat informuese. Gjithashtu edhe qasje në internet ka vetëm te zyrat e stafit; është shumë e nevojshme që rrjeti të shpërndahet në

të gjithë objektin. Alarm kundër zjarrit ka vetëm në sallën e renovuar dhe te pajisjet e dimmerave te skena e sallës, por jo edhe në hapësirat e tjera brenda objektit. Kurse sistem sigurie elektrike përveç sallës nuk ka në hapësirat tjera të objektit.

Ani pse në Bllokun A të Qendrës së Kulturës veprojnë dy institucione kulturore, pra Qendra e Kulturës dhe Teatri i Qytetit, ky bllok ka vetëm një hyrje si për stafin dhe audiencën e aktiviteteve po ashtu edhe për skenografi, vepra arti dhe rekuizita të ndryshme. Është shumë e nevojshme rihapja e hyrjes zyrtare si për dalje emergjente ashtu edhe për shërbime të tjera që do ta lehtësonin qasjen dhe mbarëvajtjen e punëve teknike në këto institucione.

Aktualisht, në këtë zonë ndodhet gjeneratori elektrik, i cili duhet të zhvendoset për të mundësuar hapjen e kësaj hyrjeje. Gjithashtu, është e nevojshme të rrenohet objekti afarist i ndërtuar aty dhe të bëhet rikonceptimi i të gjithë hapësirës në mënyrë që të integrohet shetitorja e lumit Ibër me Qendrën e Kulturës.

Një tjetër problematikë është hyrja e institucionit. Përveç kabllave dhe shtyllës elektrike në oborrin e Qendrës së Kulturës, të cilat krijojnë një pamje joestetike, kërkohet edhe demolimi i dy zyrave që i janë shtuar hyrjes. Ridizajnimi dhe rikonceptimi i kësaj hapësire do t'i jepte objektit një pamje më dinjitoze dhe do të lironte një hyrje shtesë e cila gjendet në anën e majt të hyrjes kryesore.

Qasja për personat me aftësi të kufizuara është e kufizuar vetëm në hollin e qendrës dhe sallën kryesore. Për të pasur qasje edhe në sallat e tjera, duhet të riparohet ashensori, i cili është jashtë funksionit prej disa vitesh.

Një sfidë tjetër në kushtet e punës dhe zhvillimit të aktiviteteve mbetet i ftohti që mbizotëron gjatë stinës së dimrit në hollin e qendrës, si dhe i nxehti gjatë stinës së verës në sallën e konferencave. Për zgjidhjen e këtyre dy problemeve, nevojitet kujdes në planifikimin dhe furnizimin me pelet, si dhe rregullimi i sistemit të klimatizimit dhe ventilimit në sallën e konferencave.

Për sa i përket hapësirave dhe funksionimit të organizatave të ndryshme që veprojnë në Bllokun B të Qendrës së Kulturës, gjendja në këtë pjesë është shumë e rëndë. Në këtë pjesë veprojnë afërsisht 11 organizata, disa prej të cilave nuk janë aktive prej vitesh. Në këto hapësira ka dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturën e objektit, tualetet nuk janë funksionale, ndërsa rrjeti i energjisë elektrike është në gjendje shumë të dobët. Vlen të theksohet se në vitin 2023 ka pasur një vendim që të gjitha këto hapësira të lirohen, mirëpo nuk ka pasur vullnet nga ana e këtyre organizatave që ky vendim të zbatohet. Këto hapësira duhet të trajtohen me prioritet të njëjtë sikurse pjesa e bodrumeve në këtë bllok.

Përmbledhje:

Gjendja aktuale në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" ka shënuar përmirësime të dukshme që nga viti 2023. Megjithatë, është tejet e nevojshme të rritet intensiteti i punës për zhvillimin e veprimtarisë kulturo-artistike dhe përmirësimin e përgjithshëm të institucionit. Kërkohet një bashkëpunim ndër-institucional, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, me qëllim konsolidimin e kësaj qendre dhe realizimin e investimeve kapitale në infrastrukturën e objektit.

Vizioni:

Riaktivizimi i Kinemasë

Riaktivizimi i Ansamblit

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike
Bashkëpunimi me institucione të ndryshme kulturore
Plotësimi i stafit me pozitat e lartpërmendura
Hartimi i rregullores së brendshme
Dizajnimi i logarisë zyrtare të institucionit
Ngritja e profesionalizmit dhe performancës



II. SEKTORI I RINISË

Aktivitetet e Sektorit të Rinisë

Gjatë gjashtëmuorit raportues, Sektori i Rinisë ka zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim fuqizimin e rolit të të rinjve në komunitet, promovimin e jetesës së shëndetshme, zhvillimin e kreativitetit dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me shkolla, organizata rinore, institucione shëndetësore dhe partnerë lokalë.

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Rinisë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe përfshin periudhën kohore 2026.

Ky Sektor vëmendje dhe përkushtim të veçantë i ka kushtuar fuqizimit të të rinjve, përmes formave të ndryshme të organizimit institucional duke shënuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Në veçanti DKRS njeh rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje në të gjitha proceset që e prekin statusin e të riut dhe zhvillimin individual si qytetarë aktiv sot dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm të Komunes tani dhe në të ardhmen.

Me datë 13.02.2026 ishim në një aktivitet me OJQ -REC me bashkëpunim me UNDP të financuar nga Bashkimi Evropian në forumin e dialogut me komunitete me temën anti-diskriminimi në praktikë, besimi dhe siguria ndëretnike.

Muaji: Mars 2026

Tema: Bullizmi në Shoqëri

Aktiviteti me temën “Bullizmi në shoqëri” u realizua me sukses në ambientet e Shkollës së Mesme të Ulët “Shaban Idrizi” – Zhabar, me pjesëmarrjen e nxënësve, mësimitdhënësve dhe përfaqësuesve të sektorit të rinisë.

Gjatë tryezës së diskutimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të shprehin mendimet dhe përvojat e tyre lidhur me fenomenin e bullizmit, duke e trajtuar atë si një ndër sfidat më të pranishme në jetën e të rinjve sot.

Çfarë u diskutua

Diskutimi u fokusua në disa çështje kryesore:

Kuptimi i bullizmit dhe format e tij

Nxënësit identifikuan forma të ndryshme të bullizmit, përfshirë bullizmin fizik, verbal, psikologjik dhe atë në rrjetet sociale. U theksua se bullizmi nuk ndodh vetëm në shkollë, por edhe në komunitet dhe online.

Ndikimi i bullizmit

U diskutua për pasojat negative që bullizmi ka në shëndetin mendor, vetëbesimin dhe performancën shkollore të të rinjve. Disa nxënës ndanë përvoja personale ose raste të vëzhguara, duke theksuar ndikimin emocional që shkakton bullizmi.

Roli i bashkëmoshatarëve dhe mësimitdhënësve

Pjesëmarrësit diskutuan rëndësinë e reagimit ndaj bullizmit dhe mosqëndrimit indiferent. U theksua se mbështetja nga shokët dhe ndërhyrja e mësimdhënësve janë kyçe për parandalimin e rasteve.

Strategjitë për parandalim dhe përballim

U propozuan mënyra konkrete për të luftuar bullizmin, si: raportimi i rasteve, krijimi i një ambienti më gjithëpërfshirës, organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe fuqizimi i komunikimit mes nxënësve dhe stafit shkollor.

Ndërtimi i një kulture respekti

Diskutimi përfundoi me theksimin e rëndësisë së respektit, empatisë dhe bashkëpunimit si vlera themelore për një shoqëri më të sigurt dhe mbështetëse.

Përfundime

Aktiviteti u karakterizua nga pjesëmarrje aktive dhe diskutim i hapur nga ana e nxënësve. Ai kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit për bullizmin dhe inkurajoi të rinjtë të jenë më të kujdesshëm dhe mbështetës ndaj njëri-tjetrit.

Gjithashtu, u vërejt gatishmëri nga pjesëmarrësit për të qenë pjesë e iniciativave të ardhshme që synojnë parandalimin e bullizmit dhe promovimin e një mjedisi më pozitiv në shkollë dhe komunitet.

Kohëzgjatja e aktivitetit

60 – 90 minuta

Vendi i mbajtjes

Shkolla e Mesme e Ulët “Shaban Idrizi” – Zhabar

19.03.2026

Me datë 30.04.2026 Takimi me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë.

Ne ket takim u diskutua nisma per themelimin e Këshillit Qendror Rinor në Kosovë.

Qëllimi i këtij takimi ishte informimi i organizatave të shoqeris civile, qendrave rinore, organizatave studentore, dhe strukturave të tjera rinore mbi bazën ligjore te themelimit te KQR-ës, rolin dhe mandatin e ti, si dhe procedurat dhe kriteret për përfshirje ne procesin e themelimit.

Gjithashtu ne sektorin e rinisë kemi vazhduar takime me OJQ në kuadër te politikave rinore në Mitrovicë,

Aktivitetet e muajit Qershor 2026

Gjatë muajit qershor, Sektori i Rinisë intensifikoi aktivitetet në funksion të promovimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën publike.

Janë zhvilluar takime konsultative me të rinjtë dhe përfaqësues të organizatave rinore për identifikimin e prioriteteve që do të përfshihen në planifikimin e aktiviteteve rinore për periudhën e ardhshme.

Po ashtu janë realizuar:

vizita në qendrën rinore Diakonia dhe organizatat lokale;

koordinim me partnerët institucionalë për organizimin e aktiviteteve verore;

mbështetje për iniciativa të të rinjve në fushën e edukimit joformal, vullnetarizmit dhe aktivizmit qytetar.

Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit Rinor, u zhvilluan aktivitete promovuese për rëndësinë e angazhimit vullnetar dhe pjesëmarrjes qytetare të të rinjve.

Aktivitete të muajit Korrik 2026

Edhe gjatë muajit korrik, Sektori i Rinisë vazhdoi angazhimin në koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve rinore.

Fokusi kryesor ishte:

përgatitja e aktiviteteve kulturore dhe sportive verore për të rinjtë;

koordinimi me drejtoritë komunale dhe organizatat partnere;

promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete rekreative, sportive dhe edukative.

Gjithashtu në muajin korrik është anuluar vendimi me nr. Prot. 01-453/01-0022430-2/25 i datës 18.04.2025 për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Sektorin e Rinisë.

Përfundim

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Sektori i Rinisë ka realizuar një sërë aktiviteteve që kanë kontribuar në fuqizimin e rolit të të rinjve në komunitet, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në proceset shoqërore dhe zhvillimin e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat partnere.

Përmes aktiviteteve ndërgjegjësuëse, takimeve koordinuese, pjesëmarrjes në forume dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore e lokale, janë krijuar mundësi të reja për përfshirjen aktive të të rinjve në jetën publike.

Sektori i Rinisë mbetet i përkushtuar që edhe në periudhën vijuese të vazhdojë me zbatimin e programeve dhe iniciativave që ndikojnë në zhvillimin personal, profesional dhe qytetar të të rinjve të Komunës së Mitrovicës.

III. SEKTORI I SPORTIT

Raport gjashtëmujor

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Sportit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe përfshin mbështetjen financiare të klubeve sportive për vitin 2026, si dhe raportimin e aktiviteteve të tyre.

Aktivitetet e implementuara gjatë kësaj periudhe kohore janë bazuar në Planin e Punës.


Sektori i Sportit, njëri nga tre sektorët e DKRS-së, është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve sportive dhe mbarëvajtjen e punës në këtë sektor.

Ky sektor i ka kushtuar vëmendje dhe përkushtim të veçantë klubeve sportive të qytetit tonë, përmes formave të ndryshme të organizimit institucional, duke realizuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Objekti 1: Organizimi i turnirëve tradicionalë në Komunën e Mitrovicës


Me datë 14.02.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, në bashkëpunim me Federatën e Karatesë së Kosovës, është mbajtur Kampionati Ndërkombëtar i Karatesë në Palestrën Sportive “Minatori”, ku pjesëmarrës ishin karateistë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe diaspora.

Disa pamje/foto nga kampionati i mbajtur.



Me datë 16.02.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futboll për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, ku të pranishëm ishin 7 ekiye.


Fitues i këtij turneu ishte ekipi ETC-së. Disa pamje/foto nga turneu i mbajtur.



Me datë 18.02.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne në futboll të madh për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës

Në këtë aktivitet morën pjesë: Veteranët e futbollit nga Kumanovë, Veteranët e Apolonia Fier nga Fier, Veteranët e Kosovës, Veteranët e Mitrovicës.

Disa pamje/foto nga turneu i mbajtur.




Me datë 02.03.2026, në bashkëpunim me Shoqatën Sporti Shkollor dhe DKRS-ja – Sektori i Sportit i mbajti garat shkollore në basketboll, ku të pranishëm ishin 17 ekiye të shkollave

Disa pamje/foto nga garat komunale të mbajtura në basketboll dhe hendboll.




Me datë 27.03.2026, në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit DKRS-ja – Sektori i Sportit u mbajt Streetball-i, ku të pranishëm ishin 12 ekipe të moshave të ndryshme

Disa pamje/foto nga mbajtja e Streetball-it.




Me datë 26.04.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futboll dhe shah për nder të heroit të kombit Shemsi Ahmeti “Shemi”, ku të pranishëm ishin 7 ekipe, ndërsa në shah morën pjesë 80 shahistë nga trevat shqiptare.

Disa pamje/foto nga mbajtja e turnirit Shemsi Ahmeti “Shemi”, në futboll dhe shah.



Me datë 31.05.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futboll për nder të heroit të kombit Safet Peci Boletini, ku të pranishëm ishin 7 ekipe.

Disa pamje/foto nga mbajtja e turnirit Safet Peci Boletini



Palestra e Sporteve "Minatori", veprimtarinë e saj në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive e realizon në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, duke krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të klubeve sportive.

Përveç raportimeve javore që janë përgatitur dhe dorëzuar gjatë kësaj periudhe, në përputhje me obligimet institucionale është përgatitur edhe ky raport periodik, i cili paraqet përmbledhjen e

aktiviteteve sportive, edukative, rekreative dhe kulturore të realizuara gjatë periudhës 17 janar – 17 Korrik 2026.

Gjatë kësaj periudhe, në Palestrën e Sporteve “Minatori”, përveç aktiviteteve sportive të klubeve dhe federatave, janë organizuar edhe aktivitete kulturore, edukative e rekreative, si dhe janë zhvilluar ndeshje të nivelit vendor dhe ndërkombëtar, veçanërisht në disiplinën e basketbollit.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë kronologjike dhe sipas muajve të gjitha aktivitetet sportive, rekreative, edukative dhe kulturore të zhvilluara në këtë qendër sportive gjatë periudhës 17 janar –17 Korrik 2026, si pjesë e raportit periodik gjashtëmujor.

<i>Nr.</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Klubi sportiv</i>	<i>Numri i Ndeshjeve të zhvilluara</i>
1.	Basketboll	KB. TREPÇA - Senior	13
2.	Basketboll	KB. TREPÇA – U/18	5
3.	Basketboll	KB. TREPÇA – U/16	3
4.	Basketboll	KB. TREPÇA – U/14	6
5.	Basketboll	KB. TREPÇA – U/12	3
6.	Basketboll	KB. TREPÇA – (F) U/21	4
7.	Hendboll	KH. TREPÇA - Senioret	7
8.	Hendboll	KH. TREPÇA - Kadet	9
9.	Hendboll	KH. TREPÇA - Senioret - (F)	3
10.	Volejboli	KV. TREPÇA - Seniorët - (F)	4
11.	Futsal	FC. TREPÇA - Senior	4
12.	Futsal	FC. MINATORI - Senior	5
13.	Basketboll	KB. TREPÇA – (F) U/16	5
14.	Basketboll	KB. TREPÇA – (F) U/14	5
15.	Basketboll	KB. TREPÇA – Senioret (F)	6
16.	Basketboll	KB. TREPÇA (Veteranët)	3

Sipas të dhënave të evidentuara, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Palestra e Sporteve “Minatori” është shfrytëzuar mesatarisht për rreth 88 termine stërvitore në javë, që korrespondojnë me afërsisht 132 orë shfrytëzimi në javë. Në total, gjatë periudhës gjashtëmujore janë realizuar 1, 056 termine stërvitore, përkatësisht 1, 584 orë të shfrytëzimit të palestrës sportive.

Me mbështetjen financiare nga Ministria e Sportit dhe Rinisë në Palestrën Sportive “Minatori” janë realizuar investime të rëndësishme infrastrukturore, me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rritjen e komoditetit për sportistët, klubet sportive dhe shikuesit.

Në kuadër të këtij investimi janë vendosur tribuna të reja lëvizëse (paluese) me sistem elektrik. Pas të dy koshave të basketbollit janë instaluar nga tetë (8) radhë ulësesh, ndërsa në pjesën ballore janë vendosur pesë (5) radhë ulësesh, duke e rritur kapacitetin e palestrës me gjithsej 683 ulëse të reja.

Po ashtu, gjatë realizimit të investimit janë zhvilluar vizita monitoruese nga përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse, me qëllim të përcjelljes së ecurisë së punimeve dhe verifikimit të realizimit të projektit sipas standardeve të përcaktuara.

Ky investim paraqet një përmirësim të rëndësishëm të infrastrukturës sportive, duke krijuar kushte më të mira për organizimin e ndeshjeve, garave dhe aktiviteteve të tjera sportive në Palestrën Sportive “Minatori”.

Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës së Palestrës Sportive “Minatori”, janë realizuar një sërë aktiviteteve me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe funksionimin normal të objektit.

Është bërë lysterja e korridoreve të palestrës, duke përmirësuar pamjen estetike dhe kushtet e brendshme të objektit. Po ashtu, është rinovuar dhe rregulluar zyra në hyrje të palestrës, e cila shërben për stafin administrativ dhe operativ, me qëllim të krijimit të një ambienti më funksional dhe më të përshtatshëm për punë.

Gjithashtu, është kryer lysterja dhe rregullimi i hapësirës së tribunës ku vendoset grupi i tifozëve “Torcida”, duke kontribuar në përmirësimin e pamjes dhe mirëmbajtjen e kësaj pjese të palestrës.

Në kuadër të masave për rritjen e sigurisë dhe orientimit të vizitorëve, është bërë vendosja e shenjzimeve përkatëse brenda objektit, si dhe është realizuar rregullimi dhe sistemimi i karrigeve në palestër, me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për sportistët, shikuesit dhe organizimin e aktiviteteve sportive.

Po ashtu, janë ndërmarrë aktivitete për pastrimin dhe rregullimin e hapësirës së parkingut, duke siguruar qasje më të lehtë dhe një ambient më të rregullt për përdoruesit e objektit. Për të rritur nivelin e sigurisë dhe për të parandaluar parkimin e parregullt të automjeteve, janë vendosur pengesa mbrojtëse (shtylla) përreth Palestrës Sportive “Minatori”, të cilat kontribuojnë në ruajtjen e rendit dhe mbrojtjen e infrastrukturës së objektit.

Të gjitha këto punime janë realizuar me qëllim të mirëmbajtjes së vazhdueshme të objektit, përmirësimit të kushteve të punës për stafin, krijimit të një ambienti më funksional dhe estetik, si dhe ofrimit të kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe organizimin e ngjarjeve të ndryshme në Palestrën Sportive “Minatori”.

Në kuadër të mbështetjes së institucioneve arsimore dhe përmirësimit të kushteve për zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sportive, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka realizuar shpërndarjen e inventarit në disa shkolla fillore të Komunës.

Përmes kësaj mbështetjeje janë dhuruar karrige dhe kosha lëvizës për basketboll, me qëllim të përmirësimit të kushteve në ambientet shkollore, rritjes së funksionalitetit të hapësirave të përbashkëta dhe sportive, si dhe promovimit të një mjedisi më të pastër, më të rregullt dhe më të përshtatshëm për nxënësit dhe stafin arsimor.

Ky aktivitet është pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për të mbështetur institucionet arsimore përmes sigurimit të inventarit të nevojshëm, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të ndryshme shkollore.

Më poshtë është paraqitur tabela me shkollat përfituese, si dhe sasia e inventarit të shpërndarë për secilën prej tyre.

<i>Nr.</i>	<i>Përfituesit nga DKRS-ja</i>	<i>Sasia</i>
1.	Shkolla Fillore “Migjeni”	300 karrige
2.	Shkolla Fillore “Elena Gjika”	Dy porta
3.	Shkolla Fillore “Bislim Imeri”	250 karrige
4.	Qendren Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza”	2 kosha lëvizës

Më 16.06.2026 është mbyllur Thirrja Publike për mbështetjen financiare të klubeve sportive dhe shoqatave sportive. Në kuadër të kësaj thirrjeje janë pranuar gjithsej 52 aplikime.

Komisioni për vlerësimin e aplikimeve ka përfunduar shqyrtimin administrativ dhe procesin e vlerësimit, ndërsa është bërë edhe publikimi i listës së përfituesve të mbështetjes financiare.

Aktualisht, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është në fazën e përgatitjes dhe finalizimit të kontratave me përfituesit e subvencioneve, me qëllim të nënshkrimit të tyre dhe fillimit të procedurave për realizimin e mbështetjes financiare, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.

Gjatë vitit 2026, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, me qëllim të krijimit të një partneriteti institucional për mbështetjen financiare dhe realizimin e projekteve infrastrukturore sportive në territorin e komunës.

Ky memorandum synon përmirësimin e infrastrukturës sportive, rritjen e mundësive për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe krijimin e kushteve më të mira për sportistët, klubet sportive dhe qytetarët. Përmes këtij bashkëpunimi është paraparë financimi dhe realizimi i disa projekteve me rëndësi strategjike për zhvillimin e sportit në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Projektet e përfshira në Memorandum janë:

Renovimi i Qendrës Multifunktionale “Omni Sporti”;

Ndërtimi i fushave të padelit;

Ndërtimi i fushave të tenisit;

Ndërtimi i terreneve sportive;

Ndërtimi i poligonit të qitjes në Mazhiq.

Në bazë të Memorandumit, Ministria e Sportit dhe Rinisë merr përsipër sigurimin e mbështetjes financiare për realizimin e projekteve të dakorduara, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunën në procesin e zbatimit të tyre. Nga ana tjetër, Komuna e Mitrovicës së Jugut merr përsipër sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, çështjeve pronësore, planifikimin e lokacioneve dhe koordinimin institucional për implementimin e projekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Memorandumi parasheh që për secilin projekt të hartohen anekse të veçanta, në të cilat do të përcaktohen procedurat e prokurimit, mënyra e financimit, përgjegjësitë e palëve dhe dinamika e realizimit të punimeve.

Afati i realizimit të projekteve është përcaktuar për periudhën 2026–2030, gjatë së cilës Ministria e Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës së Jugut, do të mbikëqyrë dhe koordinojë zbatimin e memorandumit, me qëllim të përfundimit me sukses të projekteve të planifikuara.

Nënshkrimi i këtij Memorandumi paraqet një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të infrastrukturës sportive në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e sportit, rekreacionit dhe aktiviteteve rinore, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe fuqizimin e sportit lokal.

Përfundim

Gjatë periudhës gjashtëmujore janar–korrik 2026, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektori i Sportit, ka realizuar me sukses aktivitetet e parapara në Planin e Punës, duke kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e sportit në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Përmes organizimit të turneve tradicionale, mbështetjes së aktiviteteve sportive, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës sportive, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me federatat, klubet sportive dhe institucionet arsimore, janë krijuar kushte më të mira për zhvillimin e sportit dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe qytetarëve në aktivitete sportive e rekreative.

Gjithashtu, realizimi i investimeve në Palestrën Sportive “Minatori”, shpallja e përfituesve të mbështetjes financiare për klubet sportive dhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës sportive dhe fuqizimit të sportit lokal.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të vazhdojë angazhimin e saj për zbatimin e projekteve të planifikuara, mbështetjen e klubeve sportive dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e sportit, rekreacionit dhe aktiviteteve rinore në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Me respekt,

Gazmend Asllani

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport

